



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS



Kuvendi i Komunës

Nr.02/

Datë: 28.02.2020

28.02.2020
28.02.2020

PROCESVERBAL

i mbledhjes së XI-të (e njëmbëdhjetë) të rregulltë të Kuvendit Komunal të Malishevës

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së -IX- të rregullt dhe i mbledhjes së -III- të jashtëzakonshme.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 01/1359 datë: 05.11.2019 e parashtruar nga Kryetari i Komunës, për shpalljen zonë me interes të përgjithshëm publik të ngastrës kadastrale nr. P-72310047-00501-34, në sipërfaqe prej 2263m², në emër të OPB Mirusha ZK-Malishevë.
3. Shqyrtimi i Raportit të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural rreth mbjelljeve vjeshtore .
4. Shqyrtimi i Raportit të Drejtorisë së Inspektoratit.
5. Shqyrtimi i Raportit nr. 02/470 datë: 19.08.2019 të Komisionit për shqyrtimin e raportit të Kompanisë “Ekoregjioni”, Njësia në Malishevë për vitin 2018.
6. Zëvendësimi i një anëtarë në Komitetin për Diasporë.
7. Zëvendësimi i një anëtarë në Komisionin Komunal të Aksionarëve.
8. Shqyrtimi i Raportit të Drejtorisë për Urbanizëm, për realizimin e projekteve kapitale për vitin 2019.
9. Formimi i Komisionit për hartimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2020.
10. Shqyrtimi i Draft-Rregullores nr. 04/183 datë: 29.10.2019 mbi pronën e paluajtshme për vitin 2020 dhe paraqitja në debat-konsultim publik .
11. Paraqitja e listës së përfituesve me farëra dhe plehra për mbjelljet vjeshtore për vitin 2019.
12. Të ndryshme.

Mbledhja mbahet me datë 13.12.2019 dhe filloi në ora 10:35 Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin 25 asambleistë, drejtorë komunalë, përfaqësuesi i OSBE-së dhe media.

Rrahim Morina: Pershendetje për të gjithë! Po e hapi mbledhjen e XI-të të rregulltë të Kuvendit të Komunës së Malishevës, korrumin e kemi dhe mund të fillojmë. Të pranishëm jemi 25 dhe prej atyre që mungojnë leje ka veç Raimorda që mungon për çështje shëndetësore. Si çdo herë e hapi debatin e jashtë rendit të ditës.

Ilaz Krasniqi: Pershendetje për të gjithë! Heqja e rrethojave të “Sheshit të Dëshmorëve” është një vendim i mirë, por këtu është marrë edhe nje vendim për heqjen e billboard-ve nga aty. Pse nuk është zbatuar ky vendim për heqjen e billboardave?

Është mirë që rrethojat të heqen edhe te Policia edhe te Komuna sepse veç për sy janë të vrazhda. Shumë here e kam ngritur çështjen e problemit të kanalizimit në Carrallukë, te lagjia “Haxhaj” kanalizimi rrjedh mbi tokë dhe ka raste që edhe fëmijët bien aty dhe paraqet rrezik për jetën e tyre. Mendoj që urgjentisht duhet të merren masat për rregullimin e atij kanalizimi. Gjithaashtu kanalizimi në fshatin Shkarashnik rrjedh mbi tokë dhe e ka kontaminuar ujin e pijshëm.

Alban Krasniqi: Pershendetje për të gjithë! Dua të flas për çështjen për të cilën shumë herë kemi diskutuar këtu e që ka të bëjë me planifikimin dhe realizimin e projekteve për çdo vit. Kuvendi që dy herë si kurrë më parë e ka votuar buxhetin edhe për këtë vit dhe atë të vitit të ardhshëm në mënyrë unanime pothuajse. Ndërsa shqetësuese mbeteten vonesat e projekteteve, mosrealizimi i projekteve të caktuara në proceset tenderuese dhe lënia anash të disa projekteve si dhe humbjen e disa prej tyre. Ne për këto nuk marrim një përgjigjie nga ana e ekzekutivi për arsyen e humbjes së këtyre projekteve. Ka projekte që janë në këtë fazë të vonë tenderimit sepse jemi në fund të vitit dhe kushtet për të punuar nuk janë të volitshme. Kërkoj një kujdes të shtuar të atyre që i mbikëqyrin këto projekte që të mos dënohen qytetarët me projekte të cilësisë të dobët e të bëhet 2-3 herë e njëjta punë.

Çështjen e Muzeut të Qytetit e kam përmend që disa herë, madje edhe në mbledhjen e kaluar nuk është bërë asgjë. Ende është pa energji elektrike, pa ujë dhe nuk e di për ngrohjen a është bërë ndonjë gjë.

Sa i përket hartave zonale dhe hartimit të projekteve është bërë një përpjekje 2-3 herë për shpalljen e tenderit por më nuk e di se çka është bërë me këtë çështje.

Çfarë po bëhet për çerdhën në Kjeve pse po vonohet ky proces? Është projektet i rëndësishëm mos ta rrezikojmë si projekt.

Nuk po kërkoj përgjigjie të më japin, po kërkoj që të marrin veprime.

Nebih Bibaj: Pershendeje për të gjithë! Shqetësimi im është për dëmtimin e buxhetit komunal që po bëhet nga vendimet gjyqësore për pagat e mësimdhënësve pensionistë. Drejtor, nga cilat projekte janë marrë këto para? Ne për kategori me vendim të Kuvendit i kemi ndarë mjetet për pagesën e tyre, ju nuk e di pse nuk e keni respektu këtë vendim.

Sa i përket vendosjes së reklamave ne e patëm nxjerrë një vendim, por ai s’po respektohet sepse para pak kohësh e kam parë duke vendosur reklama disa persona.

Edhe pse e keni bërë bazenin në Lladroc drejtor nuk ka ujë të pijshëm.

Që një vit e diskutoj çështjen e kanalizimit në Lladroc atë afër shkollës dhe ende nuk është rregulluar.

Kastriot Berisha: Pershendetje për të gjithë! Dua të flas për disa projektet që do të ishin të përfunduara ende s’kan filluar. Kur do të rregullohet parku në Tërpezë, parku në Gurbardh, kanalizimi në Gurbardh, trotuari në Gurbardhë, rugët me kubëza në lagjen “Mirdita” në

Malishevë? Kur do të rregullohen edhe gropat nëpër rrugë në Malishevë, apo i shihni ku kur kaloni andej a jo?

Grurbardhi i furnizon 7-8 fshatra me ujë të pijëshëm, por vet fshati nuk ka ujë. Pse?

Sylë Dukolli: Pershendetje për të gjithë të pranishmit! Diskutimin tim dua të nis me një falemnderim për të gjithë ata që kanë treguar humanizëm dhe kanë ndihmuar Shqipërinë për temtet e ndodhura tani!

Për të gjitha çështjet e kanalizimit ato me probleme kërkoj nga Drejtoria e Urbanizmit që ta bëjë një listë për secilin fshat e ta bëjë një projekt për rregullimin e tyre. Në qoftëse s'ka mjete ne do t'mundohemi që t'i ndajmë edhe ato veç mos të kemi probleme të tilla.

Shqetësim për të gjithë ne janë edhe qentë endacakë të cilët rrezikojnë jetën e fëmijëve tanë, dikush duhet të merret urgjentisht me këtë rast.

Duhet të merren të gjitha masat për procedurat ligore që çerdhja në Kjevë të ndërtohet dhe ky projekt të realizohet sa më parë.

Kam një kërkesë për ekzekutivin që të shtojnë pak presion te KEDS-i sepse ata fshatrat e anës sonë e kanë nrymën shumë të dobët edhe pse i kryejmë të gjitha obligimet.

Shumë herë e kemi ngritur çështjen e nënkalimit në Mleqan e ende nuk është bërë asgjë aty. Kërkoj që t'i bëhet presion Ministrisë së Infrastrukturës e të zgjidhet ky problem.

Luan Kryeziu: Pershendetje për të gjithë! Dua të diskutoj për një kërkesë e përcjellur me vendim nga LDK-ja për Kuvendin e Komunës së Malishevës e datës 22.11.2019 nga Bajrush Hoti, Kryetar i Degës së LDK-së në Malishevë. Në vendim thuhet që e tërheq nga pozita e Kryesuesit në Kuvendin Komunal në Malishevë z. Rrahim Morina dhe tani si e veteme me këshilltarët ne tjerë LDK-ja do të veprojmë si opozitë në Kuvendin e Komunës. Po në këtë kërkesë thuhet që z. Arlind Morina është shef i grupit. Po ju lexoj kërkesën në tërësi...

E di që edhe më heret LDK-ja ka pasur ferkime mes vete dhe është mirë që vet Kryesuesi ta respektojë degën e vetë të partisë.

Rrahim Morina: Është mirë që secili le t'i shoh puntë e partisë së vet dhe e dyta kjo është çështje e Kuvendit. Për këtë punë mos u shqetësoni.

Arlind Morina: Pershendetje! I kam disa kërkesa për drejtorin e Arsimit që janë nga drejtoria e shkollës "Ganimete Tërbeshi". Shkolla jonë ju është drejtuar me këto kërkesa Drejtorisë së Arsimit disa herë, por nuk kanë marrë asnjëherë përgjigje. Kërkesa e fundit me istimin tim është që t'ju mundesohet 10 nxënësve transporti për në shkollë diku 3-5 km. Njëra nga këta nxënës Edonisa Krasniqi është edhe me shëndetë jo të mirë. Po ju lexoj të gjithëve emrat.

Alban Mazreku: Pershendetje për të gjithë! Po flas edhe unë për rrugët në qytetin e Malishevës që janë të dëmtuara e me gropa pavarësisht që Drejtoria e Urbanizmit thotë që një shumë të mirë të mjeteve kanë investuar. Këto rrugë janë bërë më keq se mbas lufte.

Ngrohja qendrore në Muzeun e qytetit është rregulluar para 2 dit, por ata që e kanë rregulluar të zgjasin kabllo të rrymës për punë nga disa okale përreth sepse s'ka rrymë muzeu.

Çdo herë po e përmendi rregullimin e shtratit të lumit "Mirusha" në vlerë 250,000.00€ ashtu edhe në vitin e kaluar është nda e njëjta shumë por aty asgjë nuk është punu. Tregoj qytetarëve se ku i keni lënë ato para?

Për Sallën e Sporteve në Drenoc, janë nda mjete, është caktu lokacioni janë nxjerrë vendime por ajo as që ka filluar të ndërtohet. Pse?

Kur do të nënshkruhet kontrata për mirëmbajtjen e rrugëve gjatë sezonës dimërore sepse nëse nesër fillojnë rreshjet e borës s'ka kush t'i mirëmbajë rrugët.

Arbëreshë Krasniqi: Pershendetje për të gjithë! Tema për të cilën diskutoj Luani do të doja që flimisht të diskutohej nga Kryesuesi dhe kërkesa të diskutohej me kohë. Mbas Kryesuesit kjo temë do duhej të diskutohet nga shefat e grupeve të partive politike sepse atyre u është dërguar kjo kërkesë pavarësisht epilogut kjo temë është dashur që të diskutohet. Mbase kjo temë nuk është ngritur me kohë këtu ne kemi dyshime rreth punës së Kuvendit.

Çështjen e projektit të sallës së sporteve në Drenoc që e përmendi Albani, ai është projekt 2-vjeçar e sigurisht që do të përfundojë edhe ai projekt.

Rrahim Morina: Çështja e kryesuesit të Kuvendit nuk më shqetëso, mund ta diskutoni secili prej jush. Është e drejtë e juaja. Edhe këto çështje i zgjidhim vetë na LDK-ja, mos u shqetësoni ju. Ky Kuvend m'ka zgjedh dhe ky Kuvend kur të dojë mund t'më shkarkojë.

Alban Mazreku: S'po përmend emra. Këta po interesohen shumë për degën e LDK-së në Malishevë e nuk shqetësohen për problemet e qytetarëve. Ne e kemi shqyrtuar kërkesën e LDK-së por nuk jemi të intersuar që ta shkarkojmë Kryesuesin e Kuvendit të Malishevës.

Valon Krasniqi: Shqetësuese për qytetarët janë ato projekte që ne i kemi votuar këtu e nuk janë realizuar e jo kush është Kryesuesi i Kuvendit. Ne e dimë se sa e doni ju e liderët e juaj LDK-në që nuk kanë lë gjë pa i bërë LDK-së. Pak ka rëndësi për Valonin a është shef grupi apo diçka tjetër sepse unë të gjitha i konsideroj përgjegjësi e jo privilegje. Sikur të doja privilegje moti do t'i kisha arritur si ti e disa të tjerë. Ne këtu jemi përfaqësues të qytetarëve dhe i mbrojmë interesat e tyre. Arbëreshë, merr me projektet që janë avulluar siç është Palestra e sporteve në Drenoc e jo me çështje tjera.

Arbëreshë Krasniqi: Shumë çështje që nuk ju shkojnë për shtati ju i merrni min panevojshëm dhe ne nuk e bëjmë temë këtë çështje sepse këtu jemi për të debatuar.

Për prafolësin. Politikat e Kryesuesit të Kuvendit të Malishevës janë të mëhershme dhe vet Kryesuesi e kuptoi që nuk duhet të replikohet kjo çështje sepse e di që kjo kërkesë është dashur që të diskutohet këtu. Megjithatë kjo çështje është dashur që të diskutohet sepse dega e LDK-së në Malishevë i është drejtuar Kuvendit dhe shafave të grupeve politike ku kërkohet ndërpreja e bashkëpunimit e njëherit nuk e njeh z. Rrahim Morina si legjitim në pozitën e Kryesuesit. Në anën tjetër mos diskutimi i kësaj çështje me kohë këtu shihet që Dega e LDK-së në Malishevë nuk është serioze.

Halil Morina: Pershendetje për të gjithë! Kam një shqetësim për ato 2 pengesa në rrugën magjistrale Malisheë-Rahovec te lagjia e "Gurit" sepse janë tepër të paoërshtatshme. Kërkoj nga ju që ato të zëvendsohen me ato që janë me kritere dhe sipas rregullave të komunikacionit.

Problematikat e një subjekti politik janë të mbrendshme dhe i respektoj ato. Mirëpo, kur ajo çështje bëhet publike dhe i drejtohen Kuvendit atëherë duhet të diskutohet këtu.

Alban Krasniqi: Çështja e cila diskutuan parafolësit mendoj që nuk na përketë neve sepse janë çështje të mbrendshme të partisë dhe të mbeten aty.

Kërkoj që në emër të të gjitha çështjeve gjyqësore, investimeve skanaloze, në emër të dallavereve që janë bërë me buxhetin e Kounës, në emër të shumë padrejtësive që janë bërë në punësime, në emër të blerjeve të asambleistëve kërkoj publikisht dorëheqjen e Kryetarit të Komunës Ragip Begaj. Tani po flas si qytetar dhe të fillojnë proceset e reja në Malishevë nëse doni seriozitet.

Rrahim Morina: Po ju jap një sqarim për çerdhën në Kjevojë e cila na është kthyer për herë të dytë nga MAPL-ja. Ne e kemi përcjellë edhe njëherë lëndën ku kemi kërkuar aporovimin e vendimit e jo sqarime sepse i kemi të gjitha dokumentet e nevojshme.

Kalojmë në debatin për rendin e ditës. I kam dy kërkesa. Njëra është për ndërrim-destinim nga Bujar Morina nga fshati Gllarevë për KPF-në të cilën e kemi shqyrtuar edhe pse Drejtoria e Urbanizmit ka thënë që është tokë ndërtimore, por pas rishqyrtimit ka dalë që është tokë bujqësore, prandaj kjo duhet të hyjë si pikë në rendin e ditës.

Kërkesa tjetër është nga Albani, urdhëroni.

Alban Krasniqi: Fjala është për kërkesën e Adnan Krasniqit që jeton në lagjen "Mirëdita" dhe është në gjendje të rëndë ekonomike dhe që vuan nga një smundje të rëndë dhe që ka bërë 2 operacione tepër të kushtueshme deri më tani. Por, gjendja shëndetësore u është përkeqësuar dhe ka parashtruar një kërkesë për ndihmë ekonomike. Prandaj kërkoj që ta shpejtojmë këtë çështje sepse rasti është urgjent e mos ta presim KPF-në e radhës. Propozoj që kjo të jetë si pikë e 2 në rendin e ditës, pas procesverbalit.

Muharrem Morina: Kemi një petition edhe për një rast tjetër për një smundje gjenetike për një vajzë nga Malisheva, është mirë që ta trajtojmë edhe këtë sot.

Valon Mzreku: Pershendetje për të gjithë! Fjala është për Qëndresa Qamil Mazreku nga lagjia e "Guri" dhe një kohë të gjatë është në këtë gjendje shëndetësore. Ka pasur tajtime të rregullta shëndetësore por nuk ka treguar ndonjë rezultat. Mjekët kanë thënë që mund të shërohet jashtë vendi kështu që pavarisist donatorëve të ndryshëm ajo ka nevojë për mjete financiare sepse familja saj nuk ka asnjë të punësuar. Nëse mundenmi që në kuadër të një vendimi ta mbështesim financiarisht edhe Qëndresën.

Rrahim Morina: Pra kërkesa e Bujar Morinës për ndërrim destinim është duke u përgatitur dhe këto dy kërkesa për ndarjen e mjeteve financiare janë të propozuara që të futen në rendin e ditës.

Alban Mazreku: Kryesues, kemi një propozim për ndërrimin e anëtarit të Komitetit për Bujqësi: pasi Aliu ka shkuar tani e ai të zëvendsohet me Kushtrim Zogaj gjithashtu edhe te Komisioni për Emërtimin e rrugëve.

Rrahim Morina: Atëherë kush është pro këtyre propozimeve që të futen në rendin e ditës. Kërkesa e Bujar Morinës për ndërrim destinim, kërkesa e Alban Krasniqit për ndarjen e mjeteve financiare për Adnan Krasniqin, kërkesa e Valon Mazrekut për ndarjen e mjeteve financiare për Qëndresa Mazrekun dhe kërkesa e Alban Mazrekut për zëvendësimin e Aliut në komisione me Kushtrimin.

Për: unanimitet (19)

Me këtë votim aprovohet rendi i ditës.

Kalojmë në pikën e 1-rë të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së -IX- të rregullt dhe i mbledhjes së -III- të jashtëzakonshme. E hapi debatin për këtë pikë. Mbase s'ka diskutues kush pro aprovimit të procesverbaleve?

Për: unanimitet

Po e konstatojmë në procesverbal se kush nuk është në mbledhje. Abetare Limaj, Raimonda Krasniqi dhe Hidajete Mazreku janë më leje. Pa leje është: Behije Sertolli.

Kur u propozuan u dakorduan që si pikë e 2- të e rendit të ditës të jetë ndarja e mjeteve finaciare për ndihmë mjeksore për rastin e Adnan Krasniqit dhe Qëndresë Mazrekut. E hapi debatin, mund të propozoni edhe shumën. Pra, po dëshironi shuma për të dy rastet të jetë nga 1,000€. Kush është për?

Për: unanimitet

Valon Mazreku: Për ndarjen e këyre mjeteve kategoria për ndryshjen e subvencioneve nuk ka mjete, atëherë a mund të paguhet nga kategoria e kapitaleve.

Rrahim Morina: Në rregull Hashim e saktësojë që mjetet të merren nga projekti i ndërtimit të parkut në Marali, pra nga teprica. Kush është për?

Për: unanimitet

Kalojmë në pikën e 3-të të rendit të ditës: Zëvendësimi i anëtarëve nëpër komisione. LVV-ja ka sjellur një kërkesë që anëtari i Komisionit të Diasporës Hidajet Krasniqi të zëvendësohet me Jusuf Buzhalën. Kush është për?

Për: 14

Kundër: 0

Abstenim: 6

Alban Mazreku: Ne grupi ynë propozojmë që anëtari i Komisionit për Bujqësi Ali Morina dhe Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave për Emërtimin e Rrugëve të zëvendësohet me Kushtrim Zogaj pasi që Aliu nuk është këtu më.

Rrahim Morina: Kush është pro propozimit të Albanit që Aliu të zëvendësohet me Kushtrimin në ato dy komisione?

Për: 14

Kundër: 0

Abstenim: 6

Kemi edhe një propozim për Komisionin e Aksionarëve pasi që Aliu ka ndërru punën. Ju PDK-ja a keni ndonjë propozim?

Alban Mazreku: Ne PDK-ja propozojmë Nebih Bibaj për anëtar të këtij komisioni.

Rrahim Morina: Kush është për që Nebih Bibaj të jetë anëtar i Komisionit të Aksionarëve?

Për: 13

Kundër: 0

Abstenim: 7

Pas zgjedhjes së Nebihut anëtar i Komisionit të Aksionarëve shkojnë në pushimin e drekës dhe kthehen në ora 13:00 për vazhdimin e mbledhjes.

Sipas radhës kemi mbetur te pika e 4-ërt e rendit të ditës: Kërkesa e Buqar Morinës nga Gllareva për ndërrimin e tokës bujqësore në ndërtimore në Mleqan. Materialin ju shpërndamë dhe e hapim debatin për këtë pikë. Kjo pikë ka kaluar nëpër KPF. Urbanizmi është konsultuar me PZHK-në.

Muharrem Morina: Nëse është në fletën poseduese tokë bujqësore dhe nëse Urbanizimi është konsultuar me PZHK-në mund të marrim në vendim.

Pavarsisht që toka është afër autostradës dhe Ministria e Bujqësisë sipas nivelit të tokës përsëri vendos ajo.

Alban Krasniqi: Është mirë që të kemi kujdes e të veprojmë sipas PZHK-së sepse vet e kemi miratuar, pra kjo tokë edhe në fletëposeduese është tokë bujqësore por edhe me PZHK është e paraparë si tokë bujqësore. Pra neve duhet t'na vijë në formë të shkruar që kjo tokë bujqësore me vendim të Kuvendit t'i ndërrohet destinimi. Pra është mirë që ne të mos marrim ndonjë vendim pa u shoshitur kjo çështje dhe e kategorisë së tokës. Përgjegjësia kryesore në këtë rast i bie Drejtorisë së Kadastrës Bujqësisë dhe asaj të Urbanizmit dhe duhet t'na tregojnë se cilat procedura duhet t'i ndjekim ne.

Avdi Morina: Pershendetje për të gjithë! Kjo kërkesë erdhi gjatë seancës dhe paraprakisht është mirë që ta shohim këtë lëndë gjithaashtu këtu nuk janë asnjëri nga drejtorët që i prek kjo çështje dhe kërkoj që kjo kërkesë të shtyhet për mbledhjen tjetër.

Alban Mazreku: Parashtruesi i kërkesës në dokumente ka edhe certifikatën e biznesit dhe prona figuron në emër të biznesit dhe nuk e dimë a ka autorizim ky parashtrues. Pra herën tjetër kur të vijë kjo pikë le të jetë edhe dokumenti ose autorizimi që a ka të drejtë personi në fjalë. Edhe ne kërkojmë që në mungesë të kompletimit të dokumenteve të shtyhet kjo pikë.

Rrahim Morina: Ne lëndën mund ta çojmë në këshillim paraprak dhe varsisht prej saj mund të veprojmë më pas. Atëherë a po pajtoheri që këtë lëndë ta dërojmë për këshillim paraprak në MAPL?

Muharrem Morina: Kjo lëndë nuk ka nevojë që të votohet veç shtyhet.

Rrahim Morina: Kalojmë në pikën e 5-të të rendit të ditës: Shqyrtimi i Draft-Rregullores nr. 04/183 datë: 29.10.2019 mbi pronën e paluajtshme për vitin 2020 dhe paraqitja në debat-konsultim publik . Drejtori e ka fjalën.

Valon Mazreku: Kjo rregullore është e harmonizuar me ligjin e ri të pronës së paluajtshme dhe për dallim të rregullores së vjetër janë futur edhe tokat bujqësore dhe janë të përcatuar vlerat dhe kategoritë e pronave ashtu siç e kemi në draft. Vlerësimin e pronave e ka bërë Ministria e Financave dhe në bazë të zonave ku K. e Malishevës është e ndarë në 4 zona vlerësuese.

Nën përgjegjësinë tonë është përcaktimi i normës tatimore. Kjo normë tatimore varion nga më e ulëta nga minimumi 0.15% -1% . Arsyeja pse ne kemi paraqitur për normën tatimore minimumin është sepse mos t'i ngarkojmë qytetarët e komunës sonë me ngarkesa të larta për tatimin e pronës së paluajtshme.

Ministria e Financave ma ka përcjellur me email një raport mbi vlerësimin e përgjithshëm për objekte rezidenciale për K. e Malishevës. Në këtë rregullore nuk i keni të paraqitura vlerat për objektet rezidenciale sepse është kompetencë e Ministrisë së Financave.

Me këtë raport ata na kanë dërguar edhe një hartë ku është në tërësi K. e Malishevës ku është e ndarë në zona të vlerësimit. Nëse doni këto dokumentet e Ministrisë mund t'ju kopjojmë dhe t'ju shpërndajmë.

Rrahim Morina: E hapi debatin për këtë pikë të rendit të ditës.

Alban Krasniqi: Kjo rregullore do të del në debat publik dhe është shumë e rëndësishme për qytetarët që ata të njoftohen për normat e tatimit para se ne të marrim vendim këtu.

Problemi më i madh i kësaj rregullore është me tokën bujqësore e cila punohet e ne duhet t'i marrim tatim. Kjo që të tatimohet toka që punohet për mua më duket non-sens.

Muharremn Morina: Kjo rregullore Alban, është për objekte në përgjithësi. Ndeërsa për tokën bujqësore që punohet dhe nuk punohet është ligji.

Alban Krasniqi: Zonat i paska përcaktuar Ministria. Kam një pyetje për këtë temë. Me çfarë vendimi janë përcaktuar këto zona? A janë 4 apo 5 e më shumë zona. Nëse i ka caktuar Ministria, atëherë me çfarë baze ligjore i ka caktuar? Neve na duhet një hartë më e specifikuar jo si kjo që e kanë sjellë sepse harta përcakton vijën ndarëse në mes të zonave. Është mirë që ne të pajtohemi me minimumin e tatimit, por është mirë që t'i ndjekim edhe procedurat e të mos ngutemi.

Meqë këto të hyra i merr komuna, Valon, a keni bërë ju një planifikim të këtyre të hyrave për të rritur numrin e bizneseve që ekzistojnë? Ju keni ardhur të papërgatitur për këtë sepse nuk keni ardhur me shifra konkrete për të hyrat vetanake në vit. Nëse ju bëni një planifikim të mirë atëherë edhe ne mund të marrim një vendim më të përafërt me planifikimin e juaj.

Rrahim Morina: Organizimin e dëgjimit publik e bënë drejtorja përkatëse përmes personave zyrtarë. Këtu është edhe Avniu dhe nëse keni nevojë për ndonjë sqarim më të detajuar Avniu është këtu.

Avni Krasniqi: Pershendetje për të gjithë! Para jush e keni proket-rregulloren për Tatimin në Pronë për vitin 2020. Edhe në vitin e kaluar e kemi sqaruar këtë çështje që përgjegjësi e asambleve komunale është që vetëm të debatohet përcatimi i normës tatimore sa i përket kësaj rregullore. Ligji i ri për Tatimin në Pronë e ka përcaktuar qartë që përgjegjësia dhe caktimi i vlerave për bazën ndërtimore që ka të bëjë me vlerën e tregut është përgjegjësi e qendres në Ministri. Ata në vitin e kaluar e kanë bërë vlerësimin e të gjitha llojeve të tokave ndërsa këtë vit e kanë bërë vlerësimin për objektet e banimit e që e kanë ndarë në 5 zona. Për secilën zonë e keni vlerën e tregut që ata e kanë bërë e që nuk është kompetencë e komunës. Ndërsa norma tatimore është kompetencë e juaja dhe ju mund ta vendosni se sa doni.

Hidajete Mazreku: Ka shumë biznese e lokale që veprimtarinë e tyre e kanë shuar e ende figurojnë në Drejtorinë e Financave si veprimtari komerciale dhe duhet të paguajnë tatim. Edhe vet e kam një rast të tillë ku prona është e jona por biznesi është shuar pavarësisht që unë kam biseduar me ju ajo sot e asaj dite në regjistrin e juaj figuron dhe tatimohet. Tani me këtë

regjistrimin e ri të bizneseve dhe pronave kërkoj që bizneset që nuk funksionojnë më të mos jenë në regjistrat e juaj drejtor. Kërkoj sqarim për këtë çështje dhe të specifikohet në rregullore kjo për bizneset e shuara.

Avni Krasniqi: Regjistrimi i objekteve është bërë në vitin 2002 në tërësi. Në atë kohë ai objekt ka qenë objekt komercial. Me kalimin e kohës ai objekt e ka shuar veprimtarinë e tij komerciale. Në zyrë e tatimit në pronë e kemi për obligim mbrenda vitit me i shiku ndryshimet dhe ne i kemi reflektuar ndryshimet në objektin tënd dhe asnjë shkellje nuk është bërë. Ai objekt është i tatimuar me një normë të ulët ashtu siç është kategoria e tij. Në nëse se gjejmë pronarin e gjejmë shfrytëzuesin e atij objekti dhe ai është mbartës i tatimit në pronë dhe e ka për obligim që ta paguaj tatimin.

Rrahim Morina: Mbase s'ka diskutues të tjerë atëherë a po pajtoheni që këtë Rregullore ta hedhim në debat publik? Kush është për?

Për: 18 (unanimisht)

Kalojmë në pikën e 6-të të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 01/1359 datë: 05.11.2019 e parashtruar nga Kryetari i Komunës, për shpalljen zonë me interes të përgjithshëm publik të ngastrës kadastrale nr. P-72310047-00501-34, në sipërfaqe prej 2263m², në emër të OPB Mirusha ZK-Malishevë. Fjala është për vendimin që kemi marrë në këtë për Qendren për Paisje me Dokumente e që janë 7 ari, e vendi është gjithësej 22 ari. Së pari duhet të shkojmë në anulim të vendimit të miratuar me datë 02.03.2018 për shpalljen e zonës për interes publik të lokacionit për ndërtimin e objektit të Qendres për Paisje me Dokumente dhe Qendres për Regjistrimin e Automjeteve. Kush është pro anulimit të këtij vendimi së pari?

Për: 16

Kundër: 0

Abstenim: 2

Me këtë votim anulohet ky vendim.

Tash duhet të marrim një vendim për shpalljen e zonës së interesit 22 ari sipas kërkesës së Kryetarit që e kemi para jush. E hapim debatin për këtë pikë.

Alban Mazreku: Kryesues ne shpesh po marrim vendime këtu e të njëjtat po i anulojmë. Ky vendim është marrë para 2 viteve. Edhe atëherë personalisht për shkak të disa çështjeve së pronësisë që kanë disa qytetarë të Malishevës në gjykatë e kam deklaruar votën time kundër dhe përsëri jam kundër këtij vendim të ri që do të merret.

Rrahim Morina: Mbase s'ka debatues të tjerë e hedhi në votim këtë kërkesë. A jeni që të shpallet zonë e interesit publik ngastrës kadastrale nr. P-72310047-00501-34, në sipërfaqe prej 2263m², në emër të OPB Mirusha ZK-Malishevë?

Për: 14

Kundër: 1

Abstenim: 1

Me këtë votim shpallet zonë e interesit gastra kadastrale nr. P-72310047-00501-34, në sipërfaqe prej 2263m², në emër të OPB Mirusha ZK-Malishevë.

Kalojmë në pikën e 7-të të rendit të ditës: Shqyrtimi i Raportit të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural rreth mbjelljeve vjeshtore. Drejtori e ka fjalën.

Murat Hoxha: Pershendetje për të gjithë! Në këtë vit sipas shënimeve të grumbulluara në terren janë mbjellur këto kultura bujqësore: gruri, elbi, tërshëra dhe thekra. Këtë vit në komunën tonë janë mbjellur 3,500 hektar dhe kushtet atmosferike kanë qenë optimale për këto mbjellje. Në raport e keni një tabelë ku janë dhënë të dhënat për sipërfaqe të mbjellur dhe kulturë bujqësore.

Ilaz Krasniqi: E hapi debatin për këtë pikë.

Alban Krasniqi: Raporti neve nuk na është dorëzuar drejtor, dhe kjo sjellje nuk është sjellje korrekte me Kuvendin dhe kjo nuk është e hera e parë. Fatkeqësisht drejtor prej teje vart zhvillimi dhe mos zhvillimi i bujqësisë. Sjellja dhe arroganca jote po dëmton këtë sektor. Duhet ta kesh parasysh peshën e përgjegjësisë që ke ndaj fermerëve dhe qytetarëve të K. së Malishevës. Ti duhet të jesh bashkëpuntori më i afërt me ne, sepse përfaqësojmë interesat e qytetarëve. Drejtor, ku janë mjetet që janë paraparë për farëra dhe pleh?! Janë avulluar?! Kërkoj në emër të përgjegjësisë që ke të punojmë e ta zhvillojmë sektorin e bujqësisë dhe puno pak më ndershëm, me kritere dhe me planifikim.

Sylë Dukolli: Realisht raportin e mora tani. Këtë herë është edhe fatura që është paguar për vitet e kaluara. Alban, është mirë që të gjithë ne t'i ndihmojmë drejtorit e që të reflektojmë në zhvillimin e bujqësisë sepse ky është drejtori që është kritikuar më së shumti nga Asambleja. Është mirë që Drejtoria e Bujqësisë të ketë një plan të veprimit bashkë me fermerët e të shihet se çka është më e nevojshme që të investohet së pari në këtë sektor e t'i nxisim sa më shumë fermerët që të punojnë.

Ilaz Krasniqi: Pershendetje për të gjithë! Ne e morëm tani këtë raport dhe ne të gjithë e dimë sa po punohet toka. Toka është ndjerrinë dhe do të ishte mirë që drejtori të kishte ndonjë kontratë me bletarët sepse janë përfitues pak më të shumtë. Të gjitha subvencionet që janë ndarë në këtë sektor janë keqpërdorë dhe janë darë për militantë partiakë. Ne kërkojmë më shumë përgjegjësi nga hju sepse këto janë mjete të qytetarëve e jo t'i delegoni ashtu siç doni. Ju keni premtuar njerëzve dhe i kemi ndarë mjetet për shpërndarjen e farërave dhe pleh, por ju i keni shpenzuar mjetet, nuk keni pasur aspak përgjegjësi.

Arbëreshë Krasniqi: E përgëzoj drejtorin për punën që bënë dhe potencialin që ka për këtë sektor dhe për herë të parë në nivel Kosove ka bërë ndarjen e subvencioneve bujqësore që i ka ndihmuar direkt fermerët. Ne së bashku në atë kohë i kemi takuar të gjithë fermerët dhe i kemi diskutuar të gjitha çështjet që ata kanë ngritur duke ju premtuar që do të jemi përkrahës tyre. Sikurisht që kemi edhe vërjetje për ndarjen e subvencioneve sepse ndonjëherë edhe pa dijenin e drejtorit mund të ketë edhe ndonjë lëshim të vogël. Ndarja e subvencionve besoni që ka ndikuar pozitivisht dhe ka nxit dëshirën për punimin e tokës dhe zhvillimin e bujqësisë. Ne si Kuvend e kemi ul buxhetin për sektorin e bujqësisë e kjo po ndikon negativisht në përbushjen dhe realizimin e planeve të parapara nga Drejtoria e Bujqësisë. Kërkoj që të bëhet një Komision për monitorimin e projekteve për ndarjen e subvencionve nga kjo drejtori që do të jetë në të ardhmen.

Kryesues, mos formoni komisione që MAPL-ja po ju kthen në kundërshtim.

Sadije Krasniqi: Pershendetje për të gjithë! Ne jemi diskutuar për raportin e Drejtorisë së Bujqësisë që ne duhet të kemi një vëmendje më të madhe dhe një buxhet më të lartë për këtë

digaster në mënyrë që të realizohet i gjithë planifikimi. Planifikimi sa më i mirë kërkon buxhet më shumë, pra ne si Kuvend duhet të japim kontributin tonë duke ndarë më shumë mjete e jo të zvogëlojmë buxhetin. Është mirë të diskutohet sipas pikës së rendit të ditës. Sot e kemi raportin për të mbjellurat vjeshtore pra të diskutojmë për këtë e jo për ndarjen e subvencioneve.

Drejtor kam 2 pyetje. Në raport ishte sipërfaqja e planifikuar 3. 96 hektarë për këtë vit. Po në vitin e kaluar sa ka qenë kjo sipërfaqe për të gjitha kulturat? Sa sipërfaqe ka të mbjellura me grurë? Cila është strategjia për rritjen e sipërfaqeve të mbjellura për të gjitha kulturat, por me theks të veçantë sipërfaqja me grurë?

Hashim Vrenezi: Raporti ka ardhë sot dhe ne nuk kemi pasur kohë që ta analizojmë këtë raport. Por meqë u diskutua jashtë këtij raporti ne patëm kohë që ta dimë që raporti është shumë i mangët, planifikimi i kësaj drejtorie është shumë i mangët, qeverisja Begaj është e magnët dhe asambleistët e NISMA janë shumë të mangët sepse merren me tema jo që i përkasin rendit të ditës dhe interesit të qytetarëve por merren me ato tema që zgjasin bisedën e të rrinë në foltore.

Drejtor, nëse do që të kesh një planifikim buxhetor më të mirë duhet ta bësh një plan zhvillimor të bujqësisë konkret, me shifra konkrete të bazuara në disa analiza profesionale të digasterit që ka dhe t'na bind neve që i duhen këto mjete e ne pastaj ne të rrisim buxhetin për sektorin e bujqësisë.

Drejtor, a mund t'na tregosh se a ka pasur ndonjë përfitues të farave dhe të plehërave për këto të mbjellura sepse buxheti ka qenë i ndarë për ata fermerë që kanë më pak se 2 hektarë tokë për të mbjellur?

Rrahim Morina: Përmesë bujqësisë që është një sektor mjaft i rëndësishëm e shoh si të vetmen shpresë që mund të zhvillohet K. e Malishevës. Edhe ne jemi për ta zhvilluar bujqësisë por kur i kemi parë keqpërdorimin në ndarjen e subvencioneve atëherë e kemi ulë buxhetin për këtë sektor. Prandaj është mirë që të formohet një komision për verifikimin se ku dhe si janë ndarë ato subvencione.

Nuk mund ta kuptoj drejtorin kur thotë që ne nuk kemi ndarë farëra dhe pleh, kur ne i kemi ndarë mjetet për këtë subvencion. Ku kanë shkuar ato para drejtor? Ne do t'i çojmë të gjitha lëndët në gjykatë.

Avdi Morina: Edhe unë pajtohem që e keqja ku do që është të luftohet. Shqetësimet që i diskutuat ju sot unë i kam diskutuar shumë më heret.

Murat Hoxha: Sadije, sipërfaqja në përgjithësi ka rënë e mbjelljeve të grurit. Hashim për pyetjen që më bërë kur të vjen pika e rendit të ditës të përgjigjem.

Rrahim Morina: Kalojmë në pikën e 8-të të rendit të ditës: Shqyrtimi i Raportit të Drejtorisë së Inspektoratit. Fjalën e ka drejtori.

Dibran Kastrati: Pershendetje për të gjithë! Kërkoj falje që raporti ju ka ardhur me vonesë! Drejtoria e Inspektoriatit që puntë dhe detyrat të cilat i ka pasur është munduar që t'i kryer sipas planifikimit që ka pasur për periudhën Janar-Dhjetor 2019. Kjo drejtori i ka ndjekur me korrektësi të gjitha procedurat ligjore gjatë punës që ka bërë dhe konsiderojmë që nuk kemi bërë asnjë shkelje.

Gjatë kësaj periudhë kemi bërë inspektimin e tregut, ku janë inspektuar të gjitha marketet dhe supermarketet në Malishevë dhe në të gjitha fshatrat e saj. Kemi inspektuar të gjitha furrat gëlqerore për të cilat kemi pasur edhe raporte, gjoba dhe raste për gjykatë. Prej tyre është veç një legale dhe tjerat janë jofunksionale. Së bashku me Ministrinë e Mjedisit kemi bërë inspektimin e të gjitha gurthyesëve, seperacioneve të rrërës, fabrikave të gurit etj. Të gjithë ato që nuk kanë pasur dokumentacion të duhur i kemi marrë masat e duhura edhe në bashkëpunim me policinë. Kemi bërë inspektimin e ambientit, kemi ndarë gjoba mandatore për hudhjen e mbeturinave, kemi bërë inspektimin e të gjitha shkollave, inspektimin e lumit "Mirusha" për rastin e ngordhjes së peshqeve etj.

Të gjitha gjërat i keni të pasqyruara në raport dhe çfarë do që ju interson lidhur me këtë drejtori unë jam i gatshëm t'ju përgjigjem. Në tabelë i keni të paraqitura numrin e gjobave, raporteve etj.

Rrahim Morina: E hapi debatin për këtë pikë.

Alban Mazreku: Drejtor, kjo fotografia këtu për furrën e gëlqerës në fshatin Bardh, më bëri përshtypje. Drejtor, pas përfundimit të tregut në Malishevë dikush po i mbledh aty mbeturinat dhe po i ndez dhe po ndotet shumë ambienti përreth. A ke këtë informatë? Një market në qendër të qytetit kur po e dhez ngrohjen qendrore beso po duket sikur je në Obiliq.

Sa i përket ngordhjes së peshqeve kam një pyetje. Çka u bë me këtë çështje, ku është raporti për ngordhjen e tyre?

Ilaz Krasniqi: Drejtor po me vjen mirë që paskeni inspektuar lokalet e shisha barit dhe paskeni gjetur parregullësi. Këtë çështje e pata ngritur këtu si shqetësim.

Kam një pyetje për ngordhjen e peshqeve në lumin "Mirusha". A është gjetur shkaktari për ngordhjen e tyre?

Sa i përket ndërtimve pa leje ta kam bërë një kërkesë për ndërtimin e objektit të xhamisë në fshatin Llozicë. A e keni inspektuar këtë objekt dhe a ka leje ndërtimi sepse këtu nuk ka marrë leje. Nuk jam kundër ndërtimit të xhamisë por çdo ndërtim duhet t'i përmbahet procedurave ligjore.

Alban Krasniqi: Sipas këtij raporti të krijohet përshtypja që kjo drejtori funksionon mirë, por kur e sheh gjendjen në terren këtu krijohet një shpërputhje e madhe. Kam pasur një provojë vet si anëtar i Komisionit të Aksionarëve një kompani që ka ndërtuar në Stacionin e Autobusëve e ka dëmtuar kulmin e Stacionit dhe moti ka qenë me shi dhe aty i gjithë dokumentacioni është dëmtuar i zyrës. Ne kemi kërkuar që këtë ta inspektoj Inspektoriat dhe mexi kanë ardhur e kanë lëshuar një procesverbal e sot e asaj dite nuk e di çfarë masa janë marrë ndaj asaj kompanie. Problemi e ka nxjerë problemin këtu sepse vet objekti që është duke u ndërtuar nuk ka leje. Drejtor, a ja keni dhënë lejen ndërtimore këtij objekti, nëse po cilat kanë qenë ato kritere që është lëshuar ajo leje? Për këtë çështje keni pasur shkresë zyrtare dhe ju kam informuar për çdo gjë dhe kam kërkuar që t'i gjejmë zgjidhje kësaj problematike.

Rasti tjetër është i deponisë ilegale të mbeturinave e që është pikë mbledhëse e që bazë ligjore për funksionimin e saj s'ka. Aty bëhet ndotja e mjedisit, kundërmon dhe është pengesë për qytetarët. Ka shkresë zyrtare për këtë çështje, ka peticion nga qytetarët e asaj lagje dhe nuk është marrë asnjë masë për atë deponi. Drejtor, mosmarrja e masave ligjore aty ku ka ankesa kjo është shkelje ligjore. Këso raste ka shumë e nuk po i përmendi rend.

Ju si drejtori keni shumë punë dhe nëse doni të punoni pavarësisht se ka shkruani aty, ka shumë nevojë për inspektime në terren.

Drejtor e di edhe ti që kushtet higjieniko-sanitare në gastronomi nuk janë nivel hiç, aty helmohen njerëzit. Cilat janë masat që ju i keni marrë? Nuk pas asnjë shirit që ju keni vendos për marrjen e ndonjë mase.

Sylë Dukolli: Ky raport dallon shumë në kuadër të aktiviteteve që janë marrë në raport me atë të kaluarin. Këto 536 procerverbale a përfshihen lëndët që janë nëpër gjykata apo veç i punëve në terren?

A keni ndikim apo është detyrë e tua që t'i monitoroni marketet për çmimet e artikujve që luajnë çdo ditë? A ka mundësi që t'i regjistroni këto ndryshime të çmimve.

Nëpër fshatra ka hudhje të mbeturinave vend e pa vend dhe është mirë që të dilni nëpër terren dhe t'i merrni masat e duhura për ata që hudhin këto mbeturina.

Hidajete Mazreku: Ky raport është i përgatitur mirë por si është gjendja në terren nuk e di.

Kërkoj nga drejtori që inspektimet në terren të jenë më të shpeshta. Ka pasur disa çështje që kam ngritur këtu siç ishte papastërtia e lumit "Mirusha".

Gjendja higjienike nëpër shkolla dhe në shtëpi të shëndetit nuk është e mirë dhe nuk ka mjete të nevojshme higjienike për mirëmbajtjen e tyre.

Sa i përketë ambientit ai është i ndotur. Afër nesh tek ferma ka deponi të mbeturinave inerte aty është i tjembusht. A e keni parë atë vend? Drejtor, dilni më shumë në terren.

Sa i përketë gurthyesëve, furrave të gëlqereve ma mirë mos të flasim sepse të gjithë jemi dëshmitarë se sa e ndotin ambientin.

Drejtor, pse nuk pastrohen rrugët natën?

Behije Sertolli: Sa i përketë raportit ai ka ardhur sot dhe nuk është në rregull të diskutojmë sot për të. Raporti është i bukur për t'u parë dhe i shkruar mirë, por ne kemi probleme të shumta të inspektimit siç është ndotja e ambientit, ndërtimi pa leje si dhe cilësia e produkteve ushqimore. Ajri në K. e Malishevës është më i papastër sepse është një komunë e vogël por që operojnë shumë gurthyes duke filluar nga Astrazupi, Banja, Kërvasaria dhe Bellenica. Sa i përketë gurthyesit në Bellanicë, Nënkrjetari ka thënë që nuk i është leje për punë, ndërsa ai po vazhdon me punën. Qytetarët e Bellanicës për këtë janë të shqetësuar dhe kanë bërë një ankesë. Drejtor a keni qenë në vendin e ngjarjes dhe a keni marrë ndonjë masë?

Në raport përmendet dezinfektimi i shkollave dhe i shtëpive të shëndetit. Me ushëzimin administrativ për shkolla dihet që dizinfektimi duhet të bëhet para fillimit të mësimin. Drejtor, a është bërë dezinfektimi i shkollave para fillimit të viti shkollor? A është uji i pijshëm nëpër shkolla, a keni bërë ndonjë analizë të ujit?

Arind Morina: Drejtor, kompania që e ka fituar tenderin për shujtat e fëmijëve për shkolla, ju a keni bërë inspektimin për cilësinë e atyre shujtave? Ka shumë ankesa nga nxënësit për shujtat.

Rrahim Morina: Drejtor në raport thuhet për bashkëpunimin me Ministrinë e Mjedisit. Gjatë aksionit këto subjekte afariste nuk kanë poseduar licencë apo dokumente të nevojshme për zhvillimin e aktivitetit dhe janë mbyllur deri në kompletimin e dokumentacionit. Drejtor, pse nuk po i specifikoni se cilat janë ato subjekte afariste?

A keni bërë ndonjë procesverbal për gurthyesit se a janë plotësuar kriteret e punës dhe mbi bazën e atyre kritereve a është marrë ndonjë masë për t'ju ndërprerë punën? Ju e dini që këtu në Kuvend janë votuar disa rekomandime për gurthyesit. Çfarë vendimi keni marrë pas inspektimit të gurthyesëve?

Dibran Kastrati: Alban Mazreku, të dielave ndoshta ka ndodhur që të ketë ndezje të mbeturinave, por sigurisht që janë marrë masat. Ato 600€ janë gjoba nga djegia e mbeturinave. Në momentin kur kam marrë lajmin për ngordhjen e peshqeve e kam njoftuar AVUK-un dhe së bashku me ta kam dal në terren i kemi marrë mostrat e peshqeve dhe të ujit. Analiza e ujit është kthyer dhe ka dal në vlera normale, ndërsa analiza e peshkut nuk është kthyer ende pavarësisht institutit tim.

Baci Ilaz, ne kemi inspektuar lokalet e shisha barit dhe sipas timit ato nuk duhet të funksionojnë pavarësisht që ne i kemi marrë masat dhe janë në procedurat e gjykatës. Kemi qenë edhe në Llaziçë dhe para inspektorëve nuk është prezantuar dokumenti i kopletuar i xhamisë, por sipas Hoxhë Xhevatit ajo ka dokumentet e plotësuara.

Alban, për te Stacioni i Autobusëve vet jam dal në terren dhe ato dëmtime që janë shkaktuar nga kompania ai është zotuar që do t'i rregullojë. Sa i përket deponisë së mbeturinave ne në vazhdimësi e kemi diskutuar me "Ekoregjionin" këtë çështje dhe ata janë të intersuar që të invesojnë veç që duhet të gjendet lokacioni se ku të vendoset kjo deponi.

Sa i përket çmimeve të produkteve nëpër markete ka pasur gjoba sepse çmimi i produktit në raft dhe çmimi të raftit nuk janë përputhur. Pra i inspektojmë edhe këto. Pra ky raport nuk është veç i përshkruar në letër, por është puntë që janë kryer janë të pasqyruara këtu dhe për keto jap përgjegjësi.

Rrahim Morina: E kemi një pikë që veç duhet ta votojmë formimin e një komisioni për hartimin e planit të punës për Kuvend. Këto pika i shtymë për një ditë tjetër.

Ky Komision përbëhet nga Kryesuesi, shefat e grupeve dhe Muharrem Morina. Kush është pro kësaj përbërje?

Për: 19 (uanimisht)

Falemnderit për pjesëmarrje me kaq mbledhjen e shaplli të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në ora 16:00

Procesmbajtësja: Samir Krasniqi

Kryesuesi i Kuvendit: Rrahim Morina